



Bazuar në nenin 9 të Ligjit Nr. 2004/48 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat si i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-071 mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2004/48 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore nxjerr këtë:

Vendim shpjegues publik Nr: 02 / 2010

Për trajtimin tatimor të furnizimeve të liruara në pajtim me nënparagrafin 3.1 të Nenit 33 të Ligjit mbi TVSH-në kur furnizohen drejtpërdrejtë nga KE dhe lirimet në import në pajtim me nënparagrafin 2.1 të Nenit 30 të Ligjit mbi TVSH-në kur financohen drejtpërdrejtë nga Komisioni Evropian (KE).

Neni 1

Përshkrimi dhe Fushëveprimi

Ky përshkrim vlen për personat e tatueshëm që ekskluzivisht janë të përfshirë në kryerjen e furnizimeve të liruara në pajtim me Nenet 27 ,28 dhe nënparagrafët 1.1, 1.2, 1.3 të dhe paragrafit të Nenit 33 i Ligjit mbi TVSH-në kur kryhen furnizime që janë drejtpërdrejtë të financuara nga KE.

Neni 2

Baza Ligjore

Personat e tatueshëm që ekskluzivisht janë të përfshirë në kryerjen e furnizimeve të liruara në pajtim me nenin 27. Nenin 28 nënparagrafët 1.1, 1.2, 1.3 dhe paragrafi 3 të Nenit 33 të Ligjit mbi TVSH-në, munden pavarësisht nga nënparagrafi 2.2 i Nenit 40 të Ligjit mbi TVSH-në të kërkojnë në baza mujore rimbursimin për TVSH pa marrë parasysh shumën e kreditimit të TVSH-së për TVSH-në e zbritshme që lidhet me furnizimet që drejtpërdrejtë financohen nga KE dhe të lirohen në pajtim me nënparagrafin 3.1 të Nenit 30 të Ligjit mbi TVSH-në. Kërkesa e tillë do të merret parasysh vetëm nëse personi i tatueshëm i është përmbajtur të gjitha dispozitave Doganore dhe të TVSH-së si dhe i ka dorëzuar të gjitha deklaratat e TVSH-së dhe të gjitha deklaratat tjera tatimore për të gjitha periudhat tatimore.

Pavarësisht nga Neni 24 i Ligjit nr 2004/48, mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat si i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 03/L-071, ATK do të ndërmer veprime brenda 30 ditëve, për të shqyrtuar kërkesën për rimbursim, prej datës kur ATK e ka pranuar

kërkesën për rimbursim nga tatimpaguesi në qoftë se tatimpaguesi për këtë kërkesë mund të paraqes dëshmitë e duhura. Dëshmitë e duhura janë të specifikuar në nenin 27 të Udhëzimit 16/2009 mbi Zbatimin e Ligjit mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Neni 3 **Lirimet nga TVSH-ja**

Ligji mbi TVSH-në parasheh lirime nga TVSH-ja për furnizimet në vijim që do të trajtohen si eksporte:

Neni 33, nënparagrafi 3.1: (kalimtare) Furnizimi i mallrave dhe shërbimeve të financuara nga të ardhurat e donacioneve të bëra për buxhetin ose nëpërmes buxhetit të Kosovës ose nën mbikëqyrjen e organeve kompetente ose të financuara direkt nga kontratat për Ministrin, autoritetet lokale dhe organet tjera të rregulluara me ligj, nga qeveritë, agjencionet qeveritare, organizatat qeveritare dhe joqeveritare në mbështetje të programeve dhe projekteve humanitare dhe të rindërtimit përfshirë projektet e Integritimeve Evropiane në Kosovë;

Ligji mbi TVSH-në parasheh lirim për importet në vijim:

Neni 30, nënparagrafi 2.1 (dipozitë kalimtare) importet e mallrave të financuara nga të ardhurat e donacioneve të bëra për buxhetin ose nëpërmes buxhetit të Kosovës ose nën mbikëqyrjen e organeve kompetente ose të financuara direkt nga kontratat për përfitim të Ministrive, autoriteteve lokale dhe organeve tjera të rregulluara me ligj, nga organizatat ndërkombëtare ndër-qeveritare dhe agjencionet e tyre, qeveritë, agjencionet qeveritare, organizatat qeveritare dhe joqeveritare në mbështetje të programeve humanitare dhe të rindërtimit dhe projekteve të tjera përfshirë projektet e Integritimeve Evropiane në Kosovë;

Neni 4 **E drejta për të zbritur TVSH-në e zbritshme**

Nënparagrafi 3.2 i Nenit 36 parasheh të drejtën e zbritjes së TVSH-së së zbritshme derisa këto mallra dhe shërbime shfrytëzohen për qëllime të transaksioneve të cilat janë të liruara sipas Kreut 12 (Nenet 33-35).

Neni 5 **Rimbursimi i TVSH-së**

Nënparagrafi 2.2 i Nenit 40 parasheh se një personi i tatueshëm mund të kërkojë rimbursimin e TVSH-së, nëse shuma e kreditit të TVSH-së e tejkalon shumë mbi pesëmijë (5000)€ në fund të periudhës tatimore me kushtin që personi i tatueshëm i është përmbajtur të gjitha dispozitave doganore dhe të TVSH-së si dhe janë dorëzuar të gjitha deklaratat e TVSH-së dhe tatimeve tjera për të gjitha periudhat tatimore të kaluara.

Pavarësisht nga të dhënat e lartpërmendura, personi i tatueshëm ka të drejtë të bëjë kërkesë për Rimbursim të TVSH-së në baza mujore për TVSH-në e zbritshme që lidhet me furnizimet që drejtpërdrejtë financohen nga KE në pajtim me nënparagrafin 3.1 të Nenit 30 të Ligjit mbi TVSH-në pa marrë parasysh shumë e kreditit të TVSH-së dhe ATK do të marrë përsipër që të shqyrtojë kërkesat e tilla. Kërkesa e tillë do të merret

parasysh nga ATK vetëm nëse personi i tatueshëm ka dorëzuar të gjitha deklaratat e TVSH-së dhe të gjitha deklaratat tjera tatimore për të gjitha periudhat tatimore, për të cilat ka pasur obligim që ti dorëzoj, si dhe nëse iu është përmbajtur kërkesave të parapara me nenin 27 të Udhëzimit 16/2009 mbi Zbatimin e Ligjit mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Neni 6

Procedurat e regjistrimit për TVSH dhe për Tatim në të Ardhura

Personat e tatueshëm që nuk janë të themeluar në Kosovë por që e kanë njësinë e themeluar në një Shtet Anëtar të BE-së ose në ndonjë vend që është nënshkruar në marrëveshjes IPA (duke përjashtuar Kosovën) nuk kërkohet të regjistrohen për qëllime afariste në Kosovë bazuar në nenin 26, paragrafi 2 pika c) të Marrëveshjes IPA për furnizimet që janë drejtpërdrejtë të financuara nga KE (Kontraktuesi i KE-së).

Mirëpo nëse këta persona do të punësojnë staf vendorë, do të paguajnë qira, do të paguajnë interes apo të drejta të autorit, kërkohet që të pajisen me Numër fiskal nga ATK në mënyrë që të kenë mundësinë të mbajnë tatimin në burim. Gjithashtu ata do të pajisen me Numër Fiskal me qëllim të zbatimit të skemave speciale për rimbursim mujor pa marrë parasysh shumën e kreditit të TVSH-së.

Personat tjerë të tatueshëm do t'i nënshtrohen të gjitha procedurave të regjistrimit të biznesit siç kërkohet me Ligjet në fuqi në Kosovë.

Neni 7

Lëshimi i Faturave

Personi i tatueshëm që kryen furnizime të liruara

Një person i tatueshëm që kryen furnizimeve të liruara në pajtim me nënparagrafët 1.1, 1.2, 1.3 ose paragrafin 3 të Nenit 33 të Ligjit mbi TVSH-në duhet të lëshojë faturë në pajtim me rregullat normale për lëshimin e faturave.

Personi i tatueshëm, që nuk ngarkon me TVSH në këto fatura, është i obliguar të paraqes arsyen për lirim. Prandaj duhet të shtohet teksti në vijim:“ Furnizimi është i liruar sipas (përmendni dispozitat përkatëse të ligjit)”. Një referencë duhet t'i bëhet kontratës apo ndonjë dokumenti të ngjashëm për të cilën është bërë furnizimi.

Neni 8

Kontraktuesit dhe nënkontraktuesit

Kontraktuesit

Për furnizimet e liruara në pajtim me nënparagrafin 3.1 të Nenit 33 me arsyen se ata financohen drejtpërdrejtë nga KE do të zbatohet si më poshtë:

Personi i tatueshëm që kryen një furnizim do të referohet si kontraktues. Kontraktuesi është një person fizik apo juridik apo organizatë tjetër që ofron shërbime dhe/ose ofron furnizime të mallrave sipas kontratës që financohet drejtpërdrejtë nga KE.

Nënkontraktuesit

Furnizuesit apo nën-kontraktuesit e kontraktuesit që kryejnë furnizime të liruar nuk i nënshtrohen lirimeve speciale. Prandaj ata duhet të zbatojnë skemën e rregullt të TVSH-së dhe të ngarkojnë me TVSH nëse furnizimi nuk është i liruar nga TVSH-ja në pajtim me Nenin 27 ose Nenin 28 të Ligjit 03/L-146 mbi TVSH-në.

Është theksuar se furnizuesit dhe nënkontraktuesit e personit të tatueshëm që kryejnë furnizime të liruar do t'i nënshtrohen rregullave normale të TVSH-së: blerjet të cilat ata i kryejnë duhet të ngarkohen me TVSH dhe furnizimet e mallrave dhe shërbimeve të cilat i kryejnë i nënshtrohen TVSH-së vetëm nëse furnizimi është i liruar në pajtim me Nenin 27 ose Nenin 28 të Ligjit 03/L-146 mbi TVSH-në.

Ata mundën në pajtim me rregullat e përgjithshme të bëjnë zbritjen e TVSH-së së zbritshme në deklaratat e tyre të TVSH-së dhe në kërkesat e rimbursimit të TVSH-së dhe për këto veprohet në bazë të rregullave normale të TVSH-së.

Për qëllime të këtij Shpjegimi Publik, "Nënkontraktues" apo furnizues i kontraktuesit do të konsiderohet secili person i tatueshëm i cili nuk është nënshkruar i Kontratës në mes të KE dhe kontraktuesit të tij.

Neni 9

Kërkesa për lirim nga pagesa e TVSH-së në Import


Kontraktuesi e KE-së duhet të parashtrijë një kërkesë në Divizionin e Shërbimit të Tatimpaguesve i cili gjendet në Zyrën qendrore të ATK-së, për të marrë një autorizim për lirim të TVSH-së kur bënë importimin e mallrave.

Në mënyrë që të marrin lirimin e tillë, përveç tjerash ata duhet që të dorëzojnë kopjet e dokumenteve si në vijim :

1. Kontrata me KE-në
2. Komplet specifikacionin në lidhje me përshkrimin dhe sasi të mallrave që do të importohen dhe që lidhen ekskluzivisht me realizimin e komplet kontratës.
3. Certifikatën e Numrit Fiskal
4. Certifikatën e TVSH-së
5. Nëse deklaratat nuk i ka të proceduara, kojet e tyre
6. Nëse ka borxhe duhet të sjellë marrëveshjen e arritur për pagesë me këste dhe dëshminë që po i përmbahet asaj.

Drejtori i përgjithshëm i ATK-së
Behxhet Haliti

për: *B. Shal*



Prishtinë 13/08/2010